

VENDIM
Nr. 1374, datë 10.10.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE, QË NDIQEN
PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT
KULLOSOR¹**

(Ndryshuar me VKM nr. 435, datë 8.06.2016; nr. 592, datë 9.10.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, me propozimin e *Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:
 - a) “Heqje”, veprimin e çregjistrimit të një sipërfaqeje kullote ose livadhi nga Regjistrin e Fondit Kullor, pas miratimit nga organet përgjegjëse;
 - b) “Shtim”, veprimin e regjistrimit të një sipërfaqeje kullote ose livadhi në Regjistrin e Fondit Kullor, me prejardhje nga kategori të tjera tokash, pas miratimit nga organet përgjegjëse;
 - c) “Ndryshim destinacioni”, veprimin që pasqyron ndryshimin në Regjistrin e Fondit Kullor, për kalimin nga një kategori përdorimi në tjetrën.
2. Personat, fizikë ose juridikë apo *bashkitë*, për kullotat e livadhet *bashkiake* paraqesin në *Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit*, kërkesën për heqjen e sipërfaqes nga fondi kullor.
3. Kërkesa për heqjen e sipërfaqeve nga fondi kullor është e vlefshme vetëm kur bëhet për veprimtaritë e përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe që janë në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”.
4. Personat, fizikë ose juridikë apo *bashkitë*, për kullotat e livadhet *bashkiake*, e paraqesin kërkesën te ministri vetëm pasi kanë siguruar lejen, licencën ose dokumentin, të lëshuar nga organi i ngarkuar me ligj për miratimin e veprimtarisë.
5. Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban gjenealogjet e kërkuarit dhe të subjektit që ai përfaqëson, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë që do të ushtrojë, investimet që do të bëjë dhe kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.
6. Kërkesa shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:
 - a) *Shtuqizuar*;
 - b) *Shtuqizuar*;
 - c) Planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit.
 - d) *Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullore, e cila do t’u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullor.*
7. *Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, identifikimin e ngastrave dhe të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga marrja e kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.*

¹ VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 29 tetor 2008.
VKM nr. 435, datë 8.06.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 14 qershor 2016.
VKM nr. 592, datë 9.10.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 147, datë 16 tetor 2018.

8. Ministria mund t'ia kthejë personit, fizik ose juridik, dokumentacionin e paraqitur për plotësimin e saktësimin. Koha për plotësimin e dokumentacionit nuk llogaritet në afatin e përcaktuar për shqyrtimin e kërkesës, i cili është një muaj.

9. Në bazë të dokumentacionit të mësipërm:

a) ministri nxjerr urdhrin për heqjen nga fondi kullor, për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) ministria përgatit projektvendimin për heqjen nga fondi kullor, për sipërfaqe mbi 1 ha, dhe e dërgon atë, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave.

10. Pas miratimit të heqjes së sipërfaqes nga fondi kullor:

a) drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor bën përditësimin në regjistrimin e kullotave, që ajo administron, dhe të dhënat i përcjell në ministri;

b) ministria bën përditësimin në Regjistrin Kombëtar të Kullotave;

c) zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme bën transferimin e regjistrimit nga kategoria "Tokë e zënë me kullotë apo livadh" në kategorinë përkatëse të përdorimit.

11. Sipërfaqja, që hiqet nga fondi kullor publik, në përputhje me këtë vendim, ndryshon destinacionin e përdorimit, por, në çdo rast, mbetet në pronësi publike.

12. *Vlera e sipërfaqes kullorë të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat "a" e "b", të pikës 9, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullorë, e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullor.*

13. Kërkuesi, për shërbimin e kryer nga ministria, paguan një tarifë shërbimi, në vlerën 20 000 lekë, në llogarinë bankare të ministrisë, në kohën e paraqitjes së kërkesës. Kjo vlerë nuk kthehet edhe nëse kërkesa nuk miratohet.

14. Shtimi i sipërfaqes së fondit kullor bëhet në rastet e ndryshimit të kategorive të përdorimit të tokës nga tokë pyjore, tokë e pafrytshme ose formime nga deltat e reja të lumenjve, në kullotë apo livadh.

15. Nëse kërkesën për t'i ndryshuar destinacionin një pjese apo të gjithë kullotës a livadhit, që ka në pronësi, e bën pronari privat, në kërkesë përcaktohen:

a) edhe sipërfaqja, që do t'i ndryshohet destinacioni;

b) edhe veprimtaria për çfarë do të përdoret (veprimtaria, që do ushtrohet, apo objekti, që do të ndërtohet në të).

16. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) Kopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë së kullotës apo livadhit;

b) Studimin apo projektin e veprimtarisë që do të ushtrohet, apo të veprës që do të ndërtohet;

c) *Shfuqizuar*;

ç) Planimetrinë e sipërfaqes, që kërkohet t'i ndërrohet destinacioni, në hartë topografike, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar kufijtë natyrorë, relievi, objektet dhe kufijtë e kullotës, që mbetet pas miratimit të kërkesës;

d) Mandatpagesën e tarifës së shërbimit, sipas pikës 14 të këtij vendimi.

17. *Shfuqizuar*.

18. Ngarkohen *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe *bashkitë* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha